

RAPORTI I LIKUIDATORIT

“ CHIK SHIK ” Shpk ne likujdim e siper

Permbajta :

1. Bilanci në momentin e fillimit të procedurës së likujdimi	3
2. Detyrimet e likuidatorit	6
3. Përgjegjësitë e likuidatorit	8
4. Bilanci në datën e mbylljes së likujdimi	9
5. Veprimet e kryera gjatë procesit të likujdimi	11
6. Rezultati nga Likujdimi	13
7. Përfundimi i Likujdimi	13

RAPORT I LIKUJDIMIT TE SHOQERISE TREGETARE
“CHIK SHIK ” shpk

Per shoqerine:

“CHIK SHIK ” Shpk

Adresa : Rruga Sami Frasheri Tirane

Raport i Likuidimit të Shoqërisë

Te nderuar Zoterinj,

Me kete raport une kerkoj t’iu informoj per perfundimin e procesit te likujdimit si dhe per paraqitjen e llogarive te likujdimit duke pershkruar ne menyre te plote punen e bere nga momenti i marrjes se funksioneve te likujdatorit e deri ne realizimin e tij perfundimtar.

1. Bilanci në momentin e fillimit të procedurës së likujdimit

Pas marrjes se emerimit ne 03.Maji 2021 si likujdator i shoqerise tuaj, ne plotesim te kerkesave te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqeritë tregtare”, neni 198,. Shoqeria ” CHIK SHIK ” shpk me NIPT L81912024Q është krijuar sipas Aktit te Themelimit dhe Statutit te shoqerise ne date 14/06/2018 dhe rregjistruar 12/07/2018.

Aktiviteti kryesor i shoqerise eshte :

Bar ,Kafe, Bistro,

Akti perfshin bilancin kontabel te gjendjes se shoqerise ne çastin e hapjes se likujdimit, inventarin kontabel i te drejtave dhe detyrimeve, dokumentat ligjore te shoqerise dhe ato te marrdhenieve me te trete.

Ne menyre te permbledhur Bilanci i celjes se likujdimit paraqitet si vijon:

	Bilanci I celjes 03.05.2021
AKTIVET	
Aktive afatshkurtra	
Mjete monetare	69,515
Te drejta te arketueshme	
<i>Te tjera(Tatim fitimi)</i>	100,000
<i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i>	
Inventaret	
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	211,950
<i>Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte</i>	
Shpenzime te shtyra	
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara	
Totali i aktiveve afatshkurtra	381,465
Aktive afatgjate	
TOTALI I AKTIVEVE	381,465
DETYRIMET DHE KAPITALI	
Detyrime afatgjate	
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>	
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>	
<i>Te tjera te pagueshme</i>	3,994,687
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	
<i>Provizione te tjera</i>	
Detyrime tatimore Sigurimet	79,515
Detyrime TVSH	18,753
Totali i detyrimeve afatgjate	4,092,955
Detyrime totale	4,092,955
Kapitali dhe Rezervat	
Kapitali i nenshkruar	10,000
Primi i lidhur me kapitalin	
Rezerva te tjera	
Fitimi/(humbja) e pashperndare	-2,109,137
Fitimi/(humbja) e periudhes	-1,612,353
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	-3,711,490
Interesa jo-kontrollues	
Totali i kapitalit	-3,711,490

2. Detyrimet e likuidatorit

2.1 Regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

Bazuar në Neni 194 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", pasi administratorët kryejnë njoftimin dhe depozitim të gjithë dokumentave të nevojshme lidhur me likuiduesin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre.

Likuiduesit njoftojnë gjithashtu Qendrën Kombëtare të Biznesit për regjistrim të çdo ndryshimi për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.

2.2 Administrimi i shoqërisë nga likuiduesit

Sipas Nenit 196 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesi kryen të gjitha funksionet e administratorit nga data e emërimit të tij. Veprimtaria e likuiduesit është subjekt i mbikqyrjes nga ortakët dhe organet drejtuese të shoqërisë në likuidim.

2.3 Të drejtat e detyrimit e likuiduesit

Sipas nenit 197 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" detyra e likuiduesit është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, realizimi i aktiveve dhe shlyerja e detyrimeve të saj duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Nëse në gjykimin e likuiduesit, reklamimet e ngritura nga kreditorët përfshirë kontributet e pashlyera janë më të mëdha sesa pasuria e shoqërisë tregtare në momentin e likuidimit, atëherë likuiduesi duhet të pezullojë procedurën e likuidimit dhe t'i kërkojë gjykatës nisjen e procedurave të falimentit.

2.4 Ftesa për kreditorët

Sipas nenit 195 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesit duhet të ftojë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj.

Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, nëse ka, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

2.5 Mbrojtja e kreditorëve

Sipas nenit 199 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesi duhet të respektojë afatin prej 3 muajsh nga data e njoftimit të dytë për kreditorët, për të filluar shpërndarjen e aktiveve të mbetura.

Nëse një kreditor i shoqërisë, i njohur nga likuiduesi, nuk reklamon kërkesat e veta brenda afatit, shuma e të drejtës së tij depozitohet në gjykatë. Nëse e drejta lidhet me mallra, ato

magazinohen, duke ia ngarkuar kreditorit shpenzimet e magazinimit.

Në rastet kur detyrimin ndaj kreditorit nuk mund të shlyhet menjëherë, aktivet e shoqërisë mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i jepet një garanci e përshtatshme.

2.6 Shpërndarja e aktiveve

Sipas Nenit 201 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesi pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur është parashikuar në statut një ndarje preferenciale.

2.7 Bilancet

Sipas Nenit 198 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së tij. Në rastet kur procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit dhe pasqyrat vjetore të shoqërisë.

2.8 Raporti i likuiduesit, shpërblimi dhe shkarkimi

Sipas nenit 200 ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" aktivet e mbetura pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërblimit të likuiduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, u shpërndahen ortakëve ose aksionarëve.

Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, likuiduesit u paraqesin ortakëve të tjerë të shoqërisë apo asamblesë së përgjithshme një raport për procedurën e likuidimit.

2.9 Përfundimi i likuidimit

Sipas nenit 202 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" pas kryerjes së të gjitha procedurave për likuidimin e shoqërisë, likuiduesi njofton QKR për përfundimin e likuidimit, depoziton Raportin e Likuidimit dhe kërkon cregjistrimin e saj sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

3. Përgjegjësitë e likuidatorit

Sipas Nenit 203 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“ Përgjegjësitë e likuidatorit janë:

3.1 Përgjegjësia për t’iu përgjigjur kundërshtimeve lidhur me veprimtarinë e tij

Likuidatori ka përgjegjësinë për t’iu përgjigjur kundërshtimeve për veprimtarinë e kryer nga ana e tij deri në momentin e çregjistrimit të kompanisë në likuidim nga QKB. Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga QKB.

3.2 Përgjegjësia ndaj kreditorëve

Likuiduesit përgjigjen ndaj kreditorëve për dëmet e shkaktuara gjatë procedurës së likuidimit, në përputhje me dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë e administratorëve. Krahas likuiduesve, ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionarët përgjigjen ndaj kreditorëve të shoqërisë në mënyrë solidare deri në vlerën që u është shpërndarë. Kreditorët, të cilët nuk kanë depozituar pretendimet e tyre në afat, sipas nenit 194 të këtij ligji, apo kreditorët, për të cilët likuiduesi nuk ka qenë dhe nuk mund të kishte qenë në dijeni, nuk kanë të drejtë të ngrenë padi.

3.3 Afati për ngritjen e padive nga ana e kreditorëve

Paditë e kreditorëve të cilët janë të njohur për likuidatorin dhe kanë bërë depozitim të pretendimeve të tyre në afat, duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

4. Bilanci në datën e mbylljes së likuidimit:

Aktivët, detyrimet dhe kapitalet e veta në fund të likuidimit më 31.07.2021 paraqitet në vijim:

Lek

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	31.07.2021	Bilanci I celjes 03.05.2021
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare		69,515
Investime		
Te drejta te arketueshme		
<i>Te tjera tatim Fitimi</i>	100,000	100,000
<i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i>		
Inventaret		
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>		211,950
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara		
Totali i aktiveve afatshkurtra	100,000	381,465
TOTALI I AKTIVEVE	100,000	381,465
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Detyrime afatgjata		
<i>Te tjera te pagueshme Ortaku</i>	3,811,490	4,189,132
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
Te ardhura te shtyra		
Detyrime tatimore TVSH		18,753
Detyrime tatimore		79,515
Totali i detyrimeve afatgjata	3,811,490	
Detyrime totale	3,811,490	4,287,400
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i nenshkruar	10,000	10,000
<i>Diferenca nga perktimi i monedhes ne veprimtari te huaja</i>		
Fitimi/(humbja) e pashperndare	-2,109,137	-2,109,137
Fitimi/(humbja) e periudhes	-1,612,353	-1,806,798
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	-3,711,490	-3,905,935
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	-3,711,490	-3,905,935
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	100,000	381,465

Lek

Pasqyra e Performances (sipas natyres)

	31.07.2021		Bilanc celje 03.05.2021
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit			
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	211,950		2,452,492
<i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i>			
Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimet ne proces			
Te ardhura te tjera te shfrytezimit			
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme			
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>			-2,686,498
<i>Te tjera shpenzime</i>			-242,412
Shpenzime te personelit	-17,505	0	-1,330,380
<i>Paga dhe shperblime</i>	-15,000		-1,140,000
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	-2,505		-190,380
<i>Shpenzimet per pensionet</i>			
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi			
Shpenzime te tjera shfrytezimi			
Te ardhura te tjera			
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra			
Shpenzime financiare			
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet			
Te tjera (pershkruaj)			
Fitimi/(humbja) para tatimit	194,445		-1,806,798
Tatimi mbi fitimin			
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>			
<i>Tatim fitimi i shtyre</i>			
<i>Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve</i>			
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	194,445		-1,806,798
Te ardhura te tjera gjithepfshirese per periudhen/vitin:			
<i>Pjesa e te ardhurave gjithepfshirese nga pjesmarrjet</i>			
<i>Te tjera (pershkruaj)</i>			
Totali i te ardhurave gjithepfshirese per periudhen/vitin (A+B)	194,445		-1,806,798

5. Veprimet e kryera gjatë procesit të likujdimit

5.1 Përshkrimi i veprimeve procedurale të likujdimit

Mbi bazën e dokumentacionit dhe inventarëve të aktiveve dhe pasiveve që paraqiten më sipër, unë nisa ushtrimin e funksioneve të likujdatorit për kryerjen e operacioneve të likujdimit, të cilat përshkruhen në vijim:

5.1.1 Vlerësimi i aktiveve të shoqërisë dhe i mjaftueshmërisë së tyre për shlyerjen e detyrimeve.

Nga ana ime, në cilësinë e likujdatorit u krye një vlerësim paraprak mbi sinqeritetin dhe vërtetësinë e pasurisë së shoqërisë tregtare dhe gjendjes së llogarive kontabile, në datën 07.05.2021, përfshirë detyrimet dhe kontributet e pashlyera, me qëllim vlerësimin nëse aktivet e shoqërisë janë të mjaftueshme për të realizuar përmbushjen e këtyre pretendimeve. Ky vlerësim u krye në respektim të kërkesave të pikës 3 të nenit 197 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008.

Në gjykimin tim paraprak, me cilësinë e likuidatorit të shoqërisë, aktivet e shoqërisë mundësojnë realizimin e procesit të likujdimit.

5.1.2 Dorëzimi i Bilanceve të Shoqërisë

Bilancet vjetore të shoqërisë për vitet para vendimit të likujdimit të shoqërisë janë dorëzuar pranë autoriteteve tatimore nga administratori.

5.1.3 Publikimi i ftesës për kreditorët

Sipas ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 195, likujdatori i shoqërisë fton kreditorët e saj për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Pretendimet e kreditorëve duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të dytë të publikuar në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit(QKB).

Dy njoftimet e parashikuara janë dorëzuar pranë QKB-se në datat 07.05.2021 dhe 08.06.2021.

Pas shpalljes së dytë, në pritje të ankesave ose pretendimeve të kreditorëve por të tilla nuk kishte deri në momentin e hartimit të këtij raporti.

5.1.4 Verifikimet tatimore për rregullsinë e nxjerrjes dhe pagimit të detyrimeve tatimore

Ne ligjin “Per Proçedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë” është përcaktuar se pas futjes së shoqërisë në procesin e likuidimit, QKB-ja njofton Drejtorinë Rajonale të Tatimeve për regjistrimin e hapjes së procedurës së likuidimit, për të shprehur nëse shoqëria është në rregull me pagimin e detyrimeve tatimore.

5.2 Përshkrimi i veprimeve operacionale gjatë likuidimit

5.2.1 Kryerja e veprimeve të likuidimit, deklarimeve tatimore dhe hartimi i pasqyrave financiare

Gjatë periudhës deri në 31. Korrik 2021 u kryen deklaratat tatimore të kërkuara nga legjislacioni fiskal si, deklaratat e TVSH-së, sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, tatimin mbi pagat, u bënë pagesat e detyrimeve që u krijuan prej zhvillimit të aktivitetit për këtë periudhë. Këto veprime u reflektuan në pasqyrat financiare të datës 31.07.2021 të cilat ju do t’i miratoni me vendim të vecantë dhe do të depozitohen në QKB në mbyllje të likuidimit.

5.2.2 Veprimet e likuidimit

Transaksionet e kryera gjatë periudhës së likuidimit të shoqërisë paraqiten të përmbledhura si më poshtë:

- Gjatë periudhës nga fillimi i procedurës së likuidimit e deri në përfundim të tij janë kryer pagesat në lidhje me detyrimet tatimore, komisionet bankare e të tjera shpenzime rrjedhese të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të likuidimit.
- Shoqëria nuk ka detyrim ndaj organeve tatimore.
- Shoqëria ka detyrim ndaj ortakut për financimet e bera

6. Rezultati nga Likuidimi

Si efekt i veprimeve të likuidimit :

- Likuiditetet në arke dhe banke në fillim të hapjes së likuidimit ishin në shumën 69.515 leke. Në fund të periudhës së likuidimit shoqëria nuk ka gjendje likuiditeti në banke.

- Shoqëria arriti të bëjë shitjen e stokut prej 211,950 leke dhe të arketojë shumat duke bërë të gjitha pagesat tatimore dhe ndaj punonjësve .
- Shoqëria nuk ka detyrime ndaj furnitorit
- Shoqëria ka pa shlyer detyrimin ndaj ortakut të vetëm në shumën 3,811,490 leke
- Detyrime të sigurimeve shëndetsore dhe tvsh u likujduan nuk ka asnjë detyrim.
- Shuma e kapitaleve të veta (aktivi neto), përbehet nga :

a) Kapitali Aksionar	10.000 leke
c) Rezultati i vitit	- 1.612,353 leke
d) Fitimet/Humbje e pa shpermdara	-2.109.137 leke.

Te dhena me të detajuara janë dhene në pasqyrat financiare paraardhese dhe ato që po paraqiten për mbylljen e procedurave të likujdimit, bashkangjitur raportit.

Raporti i likujdimit dhe pasqyrat financiare të likujdimit që mbajnë datën e raportit , pasi ju të shprehëni për miratimin e tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve , do të depozitohen në QKB, për të kërkuar ç’rregjistrimin përfundimtar të shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

7. Përfundimi i Likujdimit

Raporti i likujdimit dhe pasqyrat financiare të likujdimit të mbyllura me 31/07/2021, i paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Raporti i likujdimit së bashku me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve Për Miratimin e Raportit të Likujdimit të Shoqërisë, duhet të depozitohen në QKB, për të kërkuar ç’rregjistrimin përfundimtar të shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Me aprovimin e këtij raporti likujdimi nga ana juaj shoqëria konsiderohet e likujduar dhe detyra ime si likuidator e përfunduar.

LIKUJDATORI I SHOQERISE “CHIK SHIK ” shpk

Rajmonda Jaupi



Tirane me, 31/07/2021